



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 15.03.2024

Prot.17 (shtatëmdhjetë)

Protokoll nr. 17

I mbajtur sot më datë 15.03.2024, në mbledhjen jashtë të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00 dhe në platormën messenger dhe zoom.

Rend Dite:

1.P-V "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027";

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Pranvera Begolli; 3 (tre) këshilltarë.

**Këshilltarë të pranishëm në paltrofmën messenger:**

Rudina Bregu; Ronaldo Skënderi; Aramando Dautllari; Klea Baçi; Enida Avdolli; Nersida Shiondo; Eriseld Jonusllari; Plator Çollaku; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Rovena Terolli; Marainathi Avrami; Albina Xhejo; Idlir Limllari; Dritan Çami; Andonaq Risto; Gentiana Drabo; Danjela Ibrahim; 19 (nëntëmbëdhjetë) këshilltarë.

**Të pranishëm nga Administrata:** Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu;

**Ornildi Demollari:**Në rregull fillojmë mbledhjen, jemi tre Këshilltarë prezent në sallë dhe 18 Këshilltarë të pranishëm në messenger.

**Yllson Ibrahimllari:**Të nderuar kolege të KB! Mbledhja e sotme për Miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 në nivel programi edhe pse është thirrur ne platformën online nuk ka pse shmang diskutimet cilësore ne lidhje me dokumentin e paraqitur për shqyrtim. Po te hulumtojmë mbi Strukturën e Shpenzimeve buxhetore publike në tre vitet e ardhshme, referuar klasifikimit ekonomik në shpenzime korrente Paga e sigurime dhe shpenzimet kapitale të paraqitura për shqyrtim ne këtë mbledhje te Këshillit Bashkiak vërejmë se klasifikimi i tavanit te shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027eshte si me poshtë: Viti 2025 Viti 2026 Viti 2027 27,6 % Shpenzime kapitale 27,2% 24% 23,5% Shpenzime te tjera korrente 23,4% 24,2% 48,9% Shpenzime paga e sigurime 49,4%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

48,2% 100% 100% 96,4% Shifrat që kenë paraqitur për klasifikimin e tavanit të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 tregojnë ndryshime të ndryshme në përqindje për shpenzimet kapitale, shpenzimet të tjera korrente dhe shpenzimet për paga dhe sigurime në tre vite të ndryshme. Disa vlerësime të shkurtra dhe analiza që mund të bëhen mbi këto shifra janë: Shpenzime kapitale: Përqindja e shpenzimeve kapitale bie nga 27.6% në vitin 2025 në 24% në vitin 2027. Pyetja jonë është a ka një ndryshim në fokus nga investimet afatgjata drejt shpenzimeve më të mëdha të vazhdueshme operative në vitet e ardhshme. Shpenzime të tjera korrente: Përqindja e shpenzimeve të tjera korrente rritet lehtësisht nga 23.5% në 23.4% në vitin 2026 dhe 24.2% në vitin 2027. Kjo pre supozon rritjen e kostove operative për mbështetjen e funksioneve të përditshme të njësisë. A ka një analizë për këtë? Shpenzime për paga dhe sigurime: Përqindja e shpenzimeve për paga dhe sigurime zvogëlohet gradualisht nga 48.9% në vitin 2025 në 48.2% në vitin 2027. Bashkia po bën përpjekje për të menaxhuar kostot e personelit dhe të sigurimeve në një mënyrë më efektive? Mund të kemi më shumë detaje se cilat nga zërat e buxhetit përfshihen në këtë përpjekje. Totali buxhetor sipas shumatores së zërave për vitin 2027 në tabelën përmbledhëse është 995,979, ndërsa në dokumentin e dorëzuar është 1031979 e një diferencë 36,000 njësi buxheti. Kërkoj një sqarim për këtë diferencë nëse është: Gabim në llogaritje: Mund të ketë ndodhur një gabim në llogaritje gjatë hartimit të tabelës përmbledhëse ose në dokumentin buxhetor. Gabime në dorëzim dhe përcjellje të informacionit: Ka mundësi që ka ndodhur një gabim gjatë dorëzimit dhe transmetimit të dokumentit buxhetor dhe tabelës përmbledhëse për anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ndryshime në politikën buxhetore nga momenti hartimit të dokumentit dhe momentit të hartimit të tabelës përmbledhëse. Apo ka mungesë përgjegjshmërie që na dorëzoni për shqyrtim një dokument me mangësi dhe parregullsi? Analiza e strukturës së shpenzimeve buxhetore për programin afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Maliq është një proces i rëndësishëm për të kuptuar prioritetet dhe strategjitë financiare të Bashkisë për shpenzimet buxhetore. Ndryshimet në përqindjet e shpenzimeve kapitale, shpenzimeve të tjera korrente dhe shpenzimeve për paga dhe sigurime reflektojnë sfidat dhe mundësitë që pritet të ndikojnë në buxhetin në tre vitet e ardhshme. Një analizë e kujdesshme e këtyre ndryshimeve mund të na ofrojë në anëtarëve të KB me shumë informacione të rëndësishme për zbatimin e politikave të suksesshme buxhetore, si dhe identifikimin e fushave ku mund të ketë nevojë për optimizim dhe rishikim të strategjive financiare. Gjithashtu, është e rëndësishme të theksoj se pavarësisht ndryshimeve të tavanit të shpenzimeve, monitorimi i ekzekutimit të buxhetit dhe performanca financiare mbetet një element kyç për menaxhimin efikas dhe transparent të financave publike. Dhe nësi përfaqësues të përfituesve të shërbimeve që mbulohen me këtë parashikim buxhetor kemi detyrën dhe përgjegjësinë të shikojmë me kujdes çdo dokument që na paraqitet dhe çdo ndryshim në tavanin e shpenzimeve duke kërkuar sqarime dhe transparencë nga zyrtarët përgjegjës. Për të arritur një menaxhim më të mirë të parashikimeve buxhetore dhe për të siguruar përfitime maksimale për komunitetin, bashkëpunimi dhe transparenca midis në përfaqësuesve të përfituesve të shërbimeve dhe zyrtarëve buxhetorë janë thelbësore. Kjo do të sigurojë dhe garantojë që shpenzimet të jenë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

drejtpërdrejta, efikase dhe në përputhje me nevojat dhe synimet e përgjithshme të komunitetit tonë.

**Yllson Ibrahimllari:**Përshtëndetje!Duke paraqitur analizën me objeksionet e mësipërme, deklaroj votën pro për miratim.Ditë të mbarë.

**Faslli Zholi :**Psh duke parë objeksionet e mësipërme.Deklaroj votën time pro klm.

**Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:**Kjo është një procedurë standarte që duhet të kalojë para datës 15 mars, nëse keni pyetje, mi bëni këtu, nuk po lidhem dot në ZOOM.Kanë ardhur strukturat e reja buxhetore dhe tavanet dhe miratuar edhe nga Këshilli i bashkisë brenda datës 15 mars 2024.

**Gentiana Drabo:**Ta votojmë në grup sepse nuk po lidhemi dot.

**Ornildi Demollari:**Miratojmë rendin e ditës në mesenger? E kalojmë në votim rendin e ditës? Miratohet me 21 vota pro.

**Ornildi Demollari:**Ka ndonjë pyetje për P-V?

**Petrit Kupe:**Në emër të Komisionit të Financës dhe Buxhetit, kjo është një procedurë standarte e kërkuar nga Ministria e Financës, janë marrë parasysh të gjitha rrekomandimet, jemi dakord të miratohet P-V.

**Ornildi Demollari:** E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 21 vota pro, 3 vota me karton në sallë dhe 18 online.

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet P-V me 21 vota pro, Faleminderit! Kjo ishte mbledhja.

**Mbajtës Protokolli**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRTI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**

